



## KONTRATË

### **Shitja e masës drunore në ngastrën Nr.063 Njësia menaxhuese Turuqicë;**

#### **Me**

#### **Numër,identifikues:**

615-21-2601-1-6-11

14-370/01-003454/21

#### **Neni 1 Lënda**

Kjo Kontratë e lidhur më 09/07/2021 në mes të:Komuna e Podujevës “{Autoriteti Kontraktues}”,në njërën anë,OE”Muharrem.A.Hasani,B.I(Velikorekë,11000 Podujevë” i referuar si “Blerësi”me Nr Biznesit-810780446

Ndërsa Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët për shitje të aseteve, **Shitja e masës drunore në ngastrën Nr.063 Njësia menaxhuese Turuqicë;**

#### **me numër identifikues**

615-21-2601-1-6-11

14-370/01-003454/21

dhe ka pranuar Tenderin e dorëzuar nga Blerësi për blerjen e këtyre aseteve.

#### **TANI KJO MARRËVESHTJE DËSHMON SI NË VIJIM:**

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.

#### **Neni 2 Lokacioni i Aseteve**

2.1 Lokacioni i aseteve është Lluzhanë-Podujevë

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së aseteve është Ymer Hoti,, *nr tel:* 044-241-067

#### **Neni 3 Çmimi i kontratës**

3.1 Çmimi total do të jetë:13.767.30€; [Tremdhjetëmijështatëqindgjashtëdhjetëegjashtë.tridhjetë euro}

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh Agjensia Pyjore e Kosovës sipas kontratës.

3.3 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në xhironlogarinë: **1000400070001150**

#### Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve;
- (d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5

##### Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

##### *Për Autoritetin Kontraktues*

<b>Emri:</b>	<i>Rasim Fejza</i>
<b>Pozita:</b>	<i>Menaxher i DP</i>
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>12/07/2021</i>
<b>Vula:</b>	

##### *Për Blerësin*

<b>Emri:</b>	<i>Muharrem.A.Hasani</i>
<b>Pozita:</b>	<i>Drejtor</i>
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>12/07/2021</i>
<b>Vula:</b>	

## **PJESA II E KONTRATES**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Blerësit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Asetet**" në lidhje me këtë kontratë përkufizohen në Përshkrimin e Aseteve.

"**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton autoritetin që shet Shërbimet, siç specifikohet në Fletën e të Dhënave të Tenderit

1.3 " **Blerësi**" do të thotë një person natyral ose ligjorë që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate bënë blerjen e asetëve të cilat janë objekt i kësaj kontrate.

1.4 "**Palë**" nënkupton palët që nënshkruajnë kontratën.

"**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma që do ti paguhet autoriteti kontraktues sipas specifikimit në formën e kontratës.

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 Ligjet e Kosovës në fuqi do të aplikohen në të gjitha çështjet që nuk mbulohen me dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata relevante në Prishtinë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet me shkrim në mes të palëve do të hartohen në gjuhën e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

### **Neni 3 Gjendja e Aseteve**

3.1 Autoriteti Kontraktues do të shet asetet në baza "të gjendjes aktuale, dhe lokacionit aktual" dhe nuk do të ofroj asnjë garanci apo Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve.

3.2 Blerësi do të mbaj përgjegjësinë e plotë për asetet nga data dhe koha e transferim dhe do të ketë përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet në lidhje me asetet në vazhdimësi.

### **Neni 4 Parimet e përgjithshme të pagesës**

4.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

4.2 Blerësi do të bëjë pagesën për Autoritetin Kontraktues në shumën e plotë të Kontratës, siç është përkufizuar në formën e kontratës, brenda dy javë nga data e kontratës. Autoriteti kontraktues do të lëshojë një fletëpranim si dëshmi të pagesës.

4.3 Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare të Autoritetit Kontraktues të cekur në Nenin III dhe do të konsiderohet si pagesë në datën kur kreditohet në llogarinë e Autoritetit Kontraktues.

4.4 Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë kontratë nëse Blerësi ka dështuar të paguaj Çmimin e Plotë të Kontratës brenda një jave nga afati i fundit për pagesë.

## **5. Transferi i Aseteve**

5.1 Lokacioni i asetëve është i specifikuar në Formën e Kontratës.

5.2 Blerësi do të ketë përgjegjësi të plotë dhe do të bartë të gjitha rreziqet dhe kostot lidhur me marrjen, çmontimin, largimin dhe transportimin e asetëve nga lokacioni i përcaktuar më lartë dhe do të bartë dhe paguaj të gjitha kostot e asociuara.

5.3 Blerësi do të marrë asetet brenda një jave nga data kur Autoriteti Kontraktues pranon pagesën për asetet.

5.4 Blerësi do të kontaktoj zyrtarin e emëruar në Formën e Kontratës, në adresën e autoritetit kontraktues, siç specifikohet në formën e kontratës, për të aranzhuar datën dhe kohën për marrjen e asetëve.

5.5 Blerësi do të nënshkruaj një Certifikatë të Dorëzimit, që certifikon pranimin e asetëve, në kohën e transferit.

## **Neni 6 Forca madhore**

6.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

6.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

6.3 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

6.4 Nëse Blerësi kërkon shpenzime shtesë për respektimin e udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues ose përdorimin e mënyrave alternative nën Nenin 6.3, shumata e tillë duhet të certifikohet nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 7 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

7.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

7.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit *[Specifikoni Komisionin departamentin përgjegjës për pajtim]*. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 8                    Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

8.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a)            ose një vendim nga *[specifikon gjykatën kompetente]* në pajtim me Ligjin e Kosovës; ose
- b)            kur palët pajtohen, një vendim arbitrimin. Arbitrimi i *[specifiko organin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes]* në pajtim me *[specifiko rregullat e arbitrimit (rregullat e Odës Ndërkombëtare të Biznesit, Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtarë të Tregtisë, ose procedurë tjetër të arbitrimit të njohur ndërkombëtarisht)]*

8.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjes p.sh. gjykata apo arbitrim do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës 6